



VENDIM

KOMISIONI I ETIKËS

I Përbërë nga

Fatmir BRAKA, Kryetar

Bejkush BIRÇE, N/Kryetar

Bashkim KOKA, Anëtar

Agron KULIÇAJ, Anëtar

Ardian LEKA, Anëtar

Në Tiranë më 23.06.2017

Pasi morri në shqyrtim çështjen që i përket Futboll Klub Skënderbeu

Vëren se:

Federata Shqiptare e Futbollit ka paraqitur përpara Komisionit të Etikës një numër të konsiderueshëm raportesh të *Bet Fair Detection System* (BFDS) që lidhen me klubin anëtar "Skënderbeu". Në bazë të indikacioneve të ardhura përmes raporteve BFDS (Bet Fair Detection System) rezulton se:

1. Që nga viti 2010, BFDS ka identifikuar me shume se 50 ndeshje të Klubit si të dyshimta nga pikëpamja e integritetit në garat evropiane dhe kampionatin vendas;
2. Në bazë të këtyre raporteve, Komisioni i Etikes & Disiplinës pranë UEFA ka vendosur të shpallë Klubin si të pa përshtatshëm për të marrë pjesë në UEFA CHAMPIONS LEAGUE.
3. Pas ushtrimit të ankimit nga Klubi, Trupa e Apelit për Etiken & Disiplinën ka vendosur lënien në fuqi të vendimit.
4. Pas ushtrimit të ankimit, Gjykata e Arbitrazhit Sportiv (CAS) Lozanë, ka vendosur rrëzimin e ankimit të KS Skënderbeu, lënien në fuqi të vendimit të trupës së apelit të UEFA-s.



Pasi është njohur me vendimin e arsyetuar, federata Shqiptare e Futbollit ka konstatuar se disa nga ndeshjet e dyshuara si të trukuara të raportuara nga UEFA BFDS, i përkasin kompeticioneve vendase, për këtë arsye i është drejtuar Komisionit të Etikës duke kërkuar gjykimin e çështjes.

Komisioni i Etikës, në bazë të Kodit të Etikës dhe Kodit të Disiplinës Sportive, mori në shqyrtim të gjitha raportet e paraqitura nga UEFA BFDS.

Në datën 29.09.2016 Komisioni erdhi në dijeni se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë kishte filluar procedimin penal nr.6923/2016, arsye për të cilën e pezulloi hetimin disiplinor për të pritur një konkluzion të mundshëm nga organi i akuzës, me qëllim mos paragjykimin e çështjes.

Duke parë se hetimi penal po vijonte ngadalë dhe pasi u analizua natyra disiplinore/etike e shkeljes që nuk ka domosdoshmërisht lidhje me aspektin penal të veprës, Komisioni vendosi të rifillojë hetimin duke marrë në shqyrtim të gjitha raportet e paraqitura nga BFDS së bashku me pamjet filmike shoqëruese.

Nga raportet e BFDS, rezulton se rezultati i ndeshjeve të raportuara ka qenë i manipuluar për qëllime bastesh dhe se lojtarët (bast vënësit) kishin dijeni paraprakisht për rezultatin. Nuancat e basteve të luajtura për ndeshjet e Skënderbeut rezultojnë tejet të dyshimta pasi lojtarët (bast vënësin) shfaqnin kurdoherë një besim të tepruar në bastet e luajtura.

Analiza e basteve në këto raporte është kryer duke analizuar të dhënat e basteve nga një data bazë me mbi 400 *bookmakers* në të gjithë botën. Kjo përfshin bastet përpara ndeshjes, bastet live dhe bastet alternative. Gjetjet e këtyre raporteve janë rezultat i hetimit të stërzgatur dhe analizës së faktorëve sportiv relevant që rrethojnë ndeshjen si para fillimit ashtu edhe gjatë zhvillimit të sajë. Të gjitha shënimet deprimojnë nga analize e kualifikuar nga pikëpamja e integritetit.

Kur referohet një ndeshje specifike apo performanca e një lojtari konkret, kjo bazohet në analiza subjektive dhe si e tillë duhet interpretuar. Çdo informacion apo lajm nga tregjet e basteve që ndodhet në këto raporte, është marrë nga burime private dhe/ose burime lajmesh të jashtme. Ndonëse saktësia



faktike e këtyre burimeve nuk mund të garantohet, të gjitha kontrollet e arsyeshme janë kryer në mënyrë që të sigurohet garancia e kredibilitetit të jete maksimale.

Gjykata e Arbitrazhit Sportiv CAS ka arritur në konkluzionin se raportet e UEFA BFDS janë të besueshme dhe në vetvete mjaftojnë për ta quajtur një klub apo lojtar si të përfshirë në aktivitete trukimesh me qëllime përfitimi.

Roli i BFDS është të nënvizojë lëvizjet e parregullta në tregjet e basteve para ndeshjes dhe në bastet live. Tregjet kryesore të basteve janë *Handikapi Aziatik, Total (numër golash të shënuar) dhe 1x2 (fitore në shtëpi, barazim dhe fitore jashtë)*.

Ky monitorim përdor algoritme të sofistikuar dhe modele matematikore për të krahasuar koeficientet e përlllogaritur me ato të *bookmakers-ave* me qëllim përcaktimin nëse koeficientet në një moment specifik të ndeshjes janë të rregullt ose jo.

Nëse një ndeshje paraqet një luhatje jo të rregullt të koeficienteve të basteve, atëherë sistemi gjeneron një raport me informacionin e saktë të monitoruar e që përfshin gjendjen e ekipeve në fushë, të dhënat e lojtarëve, aksionin në garë si dhe faktorë subjektiv si motivimi.

Në analizën që CAS i bën raporteve BFDS, nënvizohet se konkluzionet nxirren jo vetëm nga analiza e të dhënave të grumbulluara por edhe nga mungesa e shpjegimeve për sjelljen e lojtarëve apo faktorë të tjerë që lidhen me mospërputhjen midis aksionit në fushë dhe natyrës së basteve në tregje. Një faktor tjetër që vlen të përmendet është heqja e disa prej ndeshjeve të Skënderbeut nga *bookmaker*-sat e mëdhenj duke mos i kuotuar ndeshjet si pasojë e çrregullimeve në tregje.

Në referim të vendimit të CAS, ndonëse vërehet se sistemi BFDS ka vend për përmirësim, ato përbëjnë një provë solide që provon përfshirjen direkte apo indirekte të klubit në trukimin e ndeshjeve. Për qëllimet e luftimit të fenomenit të paracaktimit të rezultateve, për trupën gjyquese nuk është e rëndësishme provimi



i përfshirjes direkte të personave konkret në trukim pasi edhe përfshirja indirekte e klubit përbën është njësoj e dënueshme nga pikëpamja e integritetit.

Ajo çka shtrohet për analizë nga Komisioni i Etikës është vlera provuese e Raporteve BFDS. Komisioni konkludon se raportet e gjeneruara do të shërbejnë si indicje për fillimin e hetimit disiplinor por përmbajtja dhe konkluzionet e tyre do të jenë objekt i vlerësimit të komisionit rast pas rasti dhe do të validohen vetëm me vendim të trupës gjykuese të etikës.

Në rastin konkret, trupa gjykuese ka analizuar përmbajtjen e raporteve BFDS që përfshijnë Skënderbeun dhe që lidhen me kompeticionet e organizuara nga FSHF duke arritur në përfundimin se duhen përjashtuar nga gjykimi ato raporte konkluzionet e të cilave nuk mbështeten nga prova shtesë të natyrës sportive por përqendrohen vetëm tek aspekti i basteve. Po ashtu Komisioni i Etikës gjykon se duhen përjashtuar nga ky proces, raportet të cilat konkludojnë se bastet e luajtura me qëllim manipulimin e rezultatit sportiv, nuk janë materializuar.

Duke përjashtuar raportet e mësipërme, Komisioni Vlerëson si të mbështetur raportet mbi ndeshjet e mëposhtme:

- **KF Elbasani vs. Skënderbeu 1:4 (25.01.2015) "Kategoria Superiore"**

Përmbledhëse e Raportit BFDS: "Bastet e vërejtura në këtë ndeshje sugjerojnë se lojtarët (bastexhinjtë) kishin paraprakisht dijeni mbi rezultatin final. Kjo ndeshje duhet te konsiderohet sh e dyshimte dhe e manipuluar per qëllime bastesh. <https://www.youtube.com/watch?v=T-ub6OtwGGg>

Sipas raportit, rezulton se lojtarët (bastexhinjtë) treguan një konfidencë të pazakontë se Elbasani do të humbiste (kur loja ishte ende 0-0) dhe me tej se do të humbiste me të paktën 2 gola diferencë (kur loja ishte 0-1). Një trajte akoma më e çuditshme e basteve u vërejt që të shënoheshin të paktën 3 gola në total. Provat filmike dhe raportet e zyrtarëve tregojnë një mos përputhje të aksioneve në fushë me bastet e luajtura. Raporti po ashtu, thekson historinë e dyshimtë të të dy klubeve, të cilat janë listuar disa herë nga BFDS. Ndonëse forma e Skënderbeut ishte më e mirë dhe pritej fitorja e tyre, nga historia e takimeve



të fundit nuk rezulton një supremaci aq e madhe sa të justifikojë fitoren me më shumë se dy gola diferencë.

Nga përmbledhësja e basteve përpara ndeshjes, rezulton se asnjë *bookmaker* nuk e ofroi ndeshjen për 1x2 (rezultat final). Kjo nuk është diçka e re pasi, ndeshja nuk ka shumë interes.

Nga përmbledhësja e basteve në "Handikabin Aziatik" sakaq u vërejtën baste të dyshimta për Skënderbeun në tregjet SBObet pasi koeficientet u ulën nga 1.81 në hapje, në 1.27, çka përkthehet një diferencë prej 153% në fitimin neto.

Në tregjet TOTAL u vërejt një tendencë për të luajtur mbi "të paktën 3 gola". Kjo me gjasë lidhet me faktin që Skënderbeu është favorit por kur vëzhgohen aksionet e shkëputura, bastet e luajtura nuk mund të justifikohen me këtë besim.

Raportohet se në tregjet live, (Handikabin Aziatik) kishte baste të dyshimta dhe devijime u vërejtën në minutën e 33 (0-1) në SBObet, ku u ofruan koeficient prej 1.36 krahasuar me 1.60 që ishte parashikimi fillestar, çka përkthehet në një devijim prej 42% në fitim neto. Bastet sugjerojnë një besim të dyshimtë të bastexhinjve që Skënderbeu do të fitonte me të paktën dy gola diferencë. Më tej, gjatë pjesës së parë u vunë re baste që të shënoheshin edhe dy gola në një kohë kur nga pamjet filmike nuk shihet një supremaci e tillë që të justifikojë bastet, për këtë arsye një lëvizje e tillë e koeficienteve mund të shihet si tejet problematike nga pikëpamja e integritetit.

- **Skënderbeu vs. KS Flamurtari 3:1 (18.02.2015) "Kupa e Shqipërisë"**

Përmbledhëse e Raportit BFDS: Kishte baste live sh të dyshimta që të paktën tre dhe katër gola të shënoheshin në total me tregjet që pasqyruar trajta alogjike gjatë gjithë pjesës së dytë. Kur kombinohet kjo me historinë mjaft të dyshimtë të këtyre klubeve, i vetmi shpjegim logjik mund të jetë se ndeshja ka qenë e manipuluar për qëllime bastesh.



Edhe në fazat e fundit të ndeshjes, pavarësisht kohës së pakët të mbetur në dispozicion (2-1), bastexhinjtë mbetën besimplotë se të paktën edhe një gol do të shënohe. Eshhtë evidente se këto baste nuk ishin të frymëzuar nga eventet në fushën e lojës, arsye për të cilën ato duhet të shihen si tejet të dyshimta dhe si shenjë se kjo ndeshje ka shumë mundësi të ketë qenë e manipuluar duke marrë në konsideratë edhe historinë e dyshimtë të klubeve.

Nga historiku i përballjeve midis klubeve rezulton se ato janë përballur në kushte të barabarta ku Flamurtari ka fituar 4 here, Skënderbeu 3 here dhe tre ndeshje te tjera kane përfunduar ne barazim. Asnjë nga ndeshjet direkte nuk është fituara nga skuadra tjetër me më shume se 2 gola diferencë.

Nga përmbledhësja e basteve para ndeshjes rezulton se nuk kishte diferenca të mëdha që të sugjeronin se njëri nga ekipet ishte superior.

Nga përmbledhësja e basteve live në tregjet "1x2" nuk rezultojnë baste të dyshimta për t'u përmendur. Në tregjet e Handikapit Aziatik u vërejtën deviacione të moderuara ne koeficientet e parashikuar nga 2.28 në 1.6, çka tregon se ekzistonte një besimi për fitoren e Skënderbeut.

Pjesa dërrmuese e basteve u luajtën në tregjet "Totals" (me gola). Baste tejet të dyshimta u vunë re në minutën e 71 kur ndeshja ishte 2-0 në SBObet ku koeficientet që më shumë se 2.75 gola të shënoheshin u kuotuan me 1.21 nga 2.69 që ishin parashikuar, çka përkthehet në një devijim 567% në fitore neto.

Këto baste tregojnë një besim të dyshimtë se të paktën tre gola do shënoheshin, gje e cila mund të interpretohet vetëm si një provë e një ndeshje të manipuluar. Koeficientet u tregtuan thujse normalisht gjatë pjesës së parë por, me fillimin e pjesës së dytë u evidentua një trajtë bastesh që të paktën tre gola të shënoheshin. Sidoqoftë, bastet më të dyshimta u vunë re pasi Skënderbeu shënoi golin e dytë, pasi koeficientet u ulën në nivele shumë të ulëta dhe jo kompetitive, gjë e cila tregon se lojtarët e bastve kishin dijeni paraprakisht për rezultatin. Koha e basteve është shqetësuese pasi sugjeron se butexhinjtë e kanë vonuar shfaqjen e preferencës së tyre me qellim që tregjet e basteve kishin kuota normale përgjatë pjesës së parë. Ka shumë gjasa që kjo të ketë qenë një strategji e luajtjes së basteve në fund të pjesës së dytë,



kohë kur *bookmakers*-at nuk do të kishin shqetësime nga pikëpamja e integritetit për shkak të kohës së pakët të mbetur për t`u luajtur.

Një valë tjetër e basteve të dyshimta u vërejt në minutat e fundi të ndeshjes (2-1) pasi lojtarët e basteve shfaqën një konfidencë alogjike që të paktën 4 gola të shënoheshin. Këto lloj bastesh në një moment kaq të vonë të ndeshjes nuk mund të justifikohen nga asnjë faktor real pasi ndonëse aksionet e Skënderbeut u shtuan, thjeshtë koha e mbetur ishte shumë e vogël për të shënuar edhe një gol të katërt dhe normalisht koeficientet duhet të ishin ngritur dhe jo ulur siç ndodhi në rastin konkret.

- **Skënderbeu vs. KF Tirana 2:1 (21.09.2015) "Kategoria Superiore"**

Përmbledhëse e Raportit BFDS: Kishte prova të mjaftueshme se kjo ndeshje ka qenë e manipuluar në një mënyrë sh të organizuar. Provat mbështesin konkluzionin pasi janë vërejtur baste të forta dhe të dyshimta që KF Tirana do të humbte ndeshjen. Të gjitha informacionet sugjerojnë se tregjet e basteve ishin manipuluar në mënyrë të sofistikuar për qëllime korruptive.

Nga fundi i pjesës së parë, pati baste të dyshimta që Tirana ta humbte ndeshjen. Koeficientet për këtë rezultat u ulën në mënyrë të ndjeshme në një periudhë sh të vogël kohe duke treguar se baste të shumta po luheshin. Ndonëse Skënderbeu ishte favorit, pjesa e parë ishte mjaft e barabartë ndaj bastet e njëanshme të konstatuara dukshëm nuk ndikoheshin nga aksioni në fushën e lojës. Këto baste vijuan edhe gjatë pjesës së dytë çka bëri që një nga *bookmakers*-at e mëdhenj aziatik ta hiqte ndeshjen nga kuotimet përpara kohe. Kjo është një masë ekstremë për një *bookmaker* sidomos kur konsideron që ndeshja ishte e balancuar dhe rezultati vetëm 1-1.

Bastet absolutisht më të dyshimta ishin ato të fund ndeshjes (1-1) kur në 10 minutat e fundit, bastexhinjtë shprehën një besim ekstrem se do shënohej edhe një gol në favor të Skënderbeut. Koha është mjaft shqetësuese këtu pasi bastexhinjtë kanë një nivel të lartë besimi në kaq vonë në ndeshje, kur rastet e shënimit ishin të barabarta për të dy ekipet.



Nga përmbledhësja e basteve para ndeshjes vërehet një konfidencë në koeficiente nga *bookmakers*-i shqiptar XhoiLloto. Duke mbajtur parasysh se Skënderbeu ishte luajtur në kupat e Evropës vetëm 4 ditë përpara, kishte spekulime se ekipi mund të ishte i lodhur, spekulime të cilat u konfirmuan në media edhe nga trajneri Mirel Josa. Për këtë arsye nuk priteshin baste të mëdha për Skënderbeun deri në fillimin e ndeshjes. Megjithatë, ka disa faktor sportiv që mund ta justifikojnë këtë trend. Së pari, Tiranës i mungonin lojtarët Ervin Bulku e Erion Vucaj. Së dyti, pavarësisht diferencës prej vetëm 8 pikesh midis ekipeve në sezonin e kaluar dhe faktit se përballje kanë qenë përgjithësisht të luftuara, Tirana e nisi ndeshjen në formë jo shumë të mirë, kjo edhe për shkak të humbjes së ndeshjes brenda kundër Bylisit. Këto faktorë mund të kenë ndikuar në favorizimin e koeficienteve për Skënderbeun deri diku.

Nga përmbledhësja e basteve live rezulton se butexhinjtë ishin të bindur në fitoren e Skënderbeut. Kjo bindje u bë alogjike sidomos në fund të pjesës së parë kur koeficientet për Skënderbeun u ulën tej mase kundër çdo parashikimi. Midis minutës së 36 dhe minutës 45, koeficientet shkuan nga 1.83 në 1.39 pa asnjë arsye të shpjegueshme. Do të duheshin shuma të konsiderueshme parash të luajtura për Skënderbeun që koeficientet të uleshin kaq shumë çka ngre shqetësime për integritetin e ndeshjes.

Koeficientet për Skënderbeun vijuan të tregtoheshin në kuota jo normale gjatë pjesës së dytë pasi lojtaret e basteve ishin të bindur tej mase në fitoren e Skënderbeut. Është e qartë se bastexhinjtë nuk ishin të interesuar në kohën e pakët të mbetur në dispozicion dhe faktin që koeficientet ishin njëlloj prej 25 minutash tashme. Të gjitha shenjat tregojnë se shuma të mëdha parash po luheshin gjatë kësaj periudhe, çka shkaktoi uljen e ndjeshme të koeficienteve ndaj bastet duhet të konsiderohen mjaft të dyshimta dhe tregojnë se lojtaret kishin dijeni paraprakisht për rezultatin.

Si rezultat i këtyre basteve të dyshimta, disa *bookmakers* aziatik, përfshirë edhe SBObet, në minutën e 74 morën vendimin e pazakontë duke e hequr ndeshjen nga kuotimet e tyre. Një vendim i tillë për të hequr një ndeshje live kur ajo është ende e balancuar (1-1) është diçka e rrallë dhe tregon se *bookmakers-at* kishin shqetësimet e tyre lidhur me integritetin e garës.



Nga përmbledhësja e basteve në tregjet "Totals" (me gola) rezulton se në minutën e 83 (1-1) SBObet ofronte koeficiente 1.36 për më shumë se 2.5 gola krahasuar me 3.85 që ishte parashikuara, pra 570% devijim i fitimit neto. Edhe këtu, bastet më të dyshimta u vërejte në fund të fund të ndeshjes ku nga minuta e 79 e ne vijim (1-1), bastexhinjtë kishin konfidence eksstreme se të paktën edhe një gol do shënohej pasi koeficientet u ulën nga 2.06 në 1.36 brenda 4 minutave. Këto baste shume të dyshimta jo vetëm janë në kontradikte me kufizimin kohor prej 7 minutash qe kishte mbetur por edhe nivelin e besimit të bastexhijve pasi një koeficient prej 1.36 përkthehet në 74% mundësi që goli të materializohet. Kur vrojtohen paralelisht me bastet për KS Skënderbeun gjatë kësaj periudhe loje, është e qartë se lojtarët e basteve prisnin që Skënderbeu të shënonte një gol në minutat e fundit për të siguruar fitoren, dhe po përpiqeshin të maksimizonin fitimet korruptive përgjatë gjithë tregjeve të basteve në mënyrë tejet të koordinuar.

<https://www.youtube.com/watch?v=MvJ0D8JbfDs>

- **Skënderbeu vs. Tërbuni Pukë 4:0 (22.11.2015) "Kategoria Superiore"**

Përmbledhëse e Raportit BFDS: Një vlerësim sistematik i provave tregon gjurme te manipulimit te garës pasi asnjë faktor sportiv nuk mund te shpjegoje bastet e dyshimta te luajtura që Tërbuni Pukë ta humbiste ndeshjen me të paktën 4 gola, sidomos kur shumica e basteve u vunë ne 25 minutat e fundit.

Raportohet për një trend bastesh të vrojtuar në fazën e vonë të garës. Kur Skënderbeu udhëhiqte me rezultatin 3-0, bastexhinjtë pa prituri u shfaqën konfident se Tërbuni do të pësonte edhe një gol në minutat e fundit të lojës. Këto baste të njëanshme u shfaqën menjëherë dhe pa prituri në një kohë që tregjet nuk jepnin asnjë shenjë paraprake për këtë, çka tregon se 25 minutat e fundit ishin shenjëstruar specifikisht për manipulim. Ndonëse Skënderbeu ishte ekipi superior ne këtë ndeshje dhe ne këtë moment te ndeshjes, asnjë faktor sportiv i lidhur me fushën e lojës nuk mund të justifikojë nuancën agresive të basteve të vrojtuar.



Edhe me kohën e pakët të mbetur në dispozicion, (3-0) kur nuk kishte asnjë shenjë për dëmtime në fushë (që mund të shkaktonin vonesa) bastexhinjte u treguan shumë të bindur se Tërboni do të pësonte edhe një gol të katërt. Përveç kësaj, kishte baste të dyshimta që të paktën 4 gola do të shënoheshin. Pikërisht në minutën e 89, bastexhinjtë ishin me të vërtetë të bindur se goli do të materializohej. Qartësisht, këto baste duhet të shihen me shumë shqetësim pasi duket që shumica e mëdha parash janë luajtuar në mënyrë që tregjet të reagonin në këtë mënyrë. Në tërësi kur shihen tregjet live, është e qartë se lojtarët e dinin se Tërbuni do të humbte ndeshjen me të paktën 4 gola diference. Kjo i lejoi bastexhinjtë të shfrytëzonin maksimalisht tregjet live lidhur me rezultatin në 25 minutat e fundit, duke i siguruar atyre fitime të mëdha nga këto baste.

Në minutën e 90 goli i katërt i Skënderbeut u anulua fillimisht nga arbitri pasi anëtori sinjalizoi pozicion jashtë loje. Sidoqoftë, pasi e konsideroi edhe një herë, arbitri e akordoi vendimin dhe e quajti golin të rregullt. Ky episod, ndonëse duhet sinjalizuar, rezultoi se ishte vendimmarrje e drejtë nga pamjet filmike.

- **Skënderbeu vs. Vllaznia 2:1 (17.02.2016) “Kupa e Shqipërisë”**

Përmbledhëse e Raportit BFDS: Asnjë faktor sportiv nuk justifikon bastet që Skënderbeu të mos fitonte me më shumë se një gol dhe që të paktën tre gola të shënoheshin. Nga pikëpamja sportive ka prova që tregojnë se përpjekjet e lojtarëve të “Skënderbeut” ranë kur rezultati ishte 2:0, sidomos gjatë pjesës së dytë, moment kur u shënuar edhe goli i Vllaznisë, gol të cilin Orges Shehi mund ta kishte pritur lehtësisht. Kjo tregon se Skënderbeu e ka manipuluar garën me qellim përfitimin e të ardhurave nga bastet sportive.

Kishte baste të dyshimta që Skënderbeu të mos fitonte me më shumë se një gol diferencë. Këto baste u vrojtuan sapo Skënderbeu shënoi golin e parë. Në këtë moment, koeficientet ranë që Vllaznia të mos humbte me më shumë se një gol. Këto baste ngritën dyshime lidhur me integritetin e garës sepse Vllaznia sapo kishte pësuar një gol. I tillë ishte intensiteti i basteve sa një *bookmaker* aziatik e hoqi ndeshjen nga kuotimet që në pjesën e parë. Në fillim të pjesës së dytë Skënderbeu e thelloi rezultatin por në kundërshtim me aksionet në fushë, baste të tjera vijuan, kësaj rradhe që Vllaznia të mos humbiste ndeshjen



me më shumë se dy gola. Koeficientet arritën nivele shume të ulëta, çka tregon bindjen e fortë të lojtarëve se ky rezultat do të materializohej.

Kishte po ashtu baste të shumta që të shënoheshin tre gola në total. Bastet shqetësuese këtu u vërejtën që në fazat e para të ndeshjes, ku koeficientet u ulën në mënyrë të çrregullt kundër çdo pritshmërie edhe pse ndeshje ishte ende pa gola. Kjo preferencë u evidentua gjatë ndeshjes me koeficiente që u ulen në mënyrë alogjike pasi lojtarët e basteve mbetën konfident se të paktën tre gola do të shënoheshin. Theksohet se koeficientet ishin ende të rregullt në këtë moment të lojës, çka ngre dyshimin e BFDS se preferenca për t'i lozur bastet në këtë moment nuk kishte lidhje me eventet në fushën e lojës por ishin të natyrës së paligjshme.

Në pjesën e dytë kur rezultati ishte 2-0, baste shume të dyshimta u vunë re për një gol të tretë. Në tërësi tregjet tregojnë se lojtarët e basteve kishin dijeni për këtë rezultat dhe se Skënderbeu nuk do të fitonte me diferencë më shumë se një gol.

Në terma sportiv, është me rëndësi të theksohet se goli i Vllaznisë erdhi si pasojë e mbrojtjes së dobët të portierit i cili mund ta kishte parandaluar golin. Edhe përpara kësaj, mbrojtja e Skenderbeut ishte e pa mjaftueshme dhe nuk beri ndonjë përpjekje serioze për të ndaluar sulmin. Disa caste përpara golit, Vllaznia krijoi një aksion i cili nuk u kundërshtua aspak nga mbrojtja e Skënderbeut ndonëse goditja ishte jashtë kuadrantit të portës. Duke parë bastet e dyshimta që ndeshja të përfundon, sidomos në fundin e lojës, këto aksione duhen parë me shumë shqetësim.

<https://www.youtube.com/watch?v=GXYtcaNonNM>

- **Skënderbeu vs. KF Laçi 2:1 (20.04.2016)**

Përmbledhëse e Raportit BFDS: Kishte baste përpara ndeshjes që Skënderbeu te mos fitonte ndeshje me më shume se një gol. Bastet e forta u vërejtën menjëherë sapo tregjet u hapën dhe koeficientet u ulën në mënyrë drastike. Ndonëse Skënderbeu ishte me mungesa ne formacion dhe kishte ndryshuar disa lojtarë, nuk mund të përbëjë lajm të tillë sa të justifikojë bastet e forta të shënuara si dhe përjashtohet që



bookmakers-at të kenë kalkuluar koeficientet aq gabim. Ne tërersi, bastet ngrenë shqetësime lidhur me integritetin e ndeshjes.

Ne bastet live, u luajt që KF Laçi të humbte dhe të ekzaktësisht tre gola të shënoheshin. Për këtë u evidentuan baste të shumta dhe me vlera të mëdha në të gjitha tregjet. Bastet live vijuan edhe gjatë pushimit të ndeshjes edhe pse nuk kishte lojë që të krijonte një bindje tek lojtarët e basteve. Bastet u shtuan gjatë pjesës së dytë pasi lojtarët vijonin të luanin që Laçi të humbiste, gjë e cila nuk shpjegohej dot me faktorin sportiv që zhvillohej në fushë. Bastet ishin ekstreme, aq sa disa *bookmakers* aziatik e hoqën ndeshjen nga kuotimi, çka tregon shqetësimin e tyre për integritetin e lojës.

Në bastet para ndeshjes dhe ato live, provohet se rezultati 2-1 ishte i paracaktuar dhe lojtarët e basteve përfituan shuma të mëdha në të gjitha tregjet e basteve. Këto nuanca bastesh tregojnë një planifikim të kujdesshëm dhe ekzekutim perfekt.

Nga pikëpamja sportive, mbrojtja e të dy ekipeve ishte e dobët dhe kjo duhet nënvizuar. Mbrojtësi i KS Skënderbeu Renato Arapi ishte komplet jashtë pozicioni, duke i dhënë Marko Cetkovic-it hapësirë për të shënuar golin e Laçit. Mbrojtja e dobët me tej u demonstrua nga mbrojtësi i Lacit Arjan Sheta pasi dështoi të arrinte Sebino Plakun për golin e fitores. Duke vërejtur bastet sportive, BFDS është shumë e bindur se kjo ndeshje është manipuluar për qëllime përfitimesh.

Nga analiza e basteve *live* rezulton se lojtarët kishin besim të dyshimte se KF Laci nuk do të humbiste me më shumë se 1 gol diferencë. Bastet e forta të vërejtura menjëherë sapo tregjet ishin hapur, nuk justifikohen dot sipas BFDS nga faktorë të tjerë veç trukimit.

Nga bastet live raportohet po ashtu se në minutën e 52 kur ndeshja ishte 0-0, BetISN e kutonte Skënderbeun me 1.16 krahasuar me 2.36 që ishte parashikimi, çka përkthehet në 589% devijim në fitim neto. Bastet tregojnë një besim të tepruar se Skënderbeu do të fitonte. Në fillim të pjesës së parë bastexhinjtë treguan një bindje absolute, tejet agresive tek Skënderbeu. Ajo që e bën edhe më të dyshimtë situatën është se bastet vijuan edhe në pushimin midis pjesëve ndonëse nuk kishte aksion në fushë. Midis



minutës së 39 dhe 52, koeficientet e Skënderbeut ranë nga 1.89 në 1.16 pa asnjë arsye të shpjegueshme. Në një treg normal, koeficientet e Skënderbeut duhet të ishin rritur gradualisht pasi mbetej më pak kohë për të shënuar. Çuditërisht, krejt e kundërta ndodhi këtu pasi koeficientet ranë në nivele jo reale për një fragment shume të shkurtër kohe.

Vlen të theksohet se BetISN vendosi ta heqë ndeshjen nga kuotimi para kohe, pak pas shënimit të golit të parë nga Skënderbeu. Gjithashtu, të gjithë *bookmakers*-at aziatik e hoqën ndeshjet nga kuotimi kur ishte ende 0-0. Ky vendim drastik tregon shqetësimin e *bookmakers*-ave për natyrën e basteve të luajtura në këtë ndeshje.

E njëjta gjë edhe me tregjet "Totals" ku raportohet një konfidencë e dyshimtë se të paktën tre gola do të shënoheshin. Në mes të pjesës së parë, lojtarët e basteve treguan një agresivitet të madh në "*overs*" (gola në total) pasi koeficientet u ulën ndjeshëm kundrejt pritshmërive. Bastet u përkeqësuan gjatë kohës që ndeshja vijonte 0-0. Psh: koeficienti për mbi 2 gola ra nga 1.98 në min.32 në 1.12 në minutën 51. Koeficientët për një minimum golash nuk do të kuotoheshin në këtë mënyrë nëse nuk do kishte një masë e tërë bastesh të dyshimta. Kjo pasi në një treg normal, koeficientet do të ishin rritur në mënyrë të konsiderueshme, ndaj kjo tregon bastet e mëdha që janë luajtur që të paktën tre gola të shënoheshin.

Një valë tjetër bastesh të dyshimta u vërejt kur ndeshja ishte 1-1 pasi lojtarët e basteve treguan një binde se edhe një gol do të shënohej. Devijime serioze u evidentuan deri në minutën e 79, minutë në të cilën Skënderbeu shënoi golin. Pa asnjë shpjegim, menjëherë pas golit, lojtarët luajtën me siguri të plotë me "*unders*" (nuk ka më gol). Psh: në minutën e 82, MaxBet ofronte koeficiente 1.10 për më pak se 3.5 gola krahasuar me 1.43 që ishte parashikuar.

Kjo periudhë e ndeshjes reflekton besimin e bastexhinjve se nuk do të kishte më gola të shënuar. Baste filluan menjëherë në minutën e 80. Të shohësh këtë lloj preference bastesh dhe për më tepër këtë ndryshim drastik të trendit nga "gol radhe" në "nuk ka më gola" brenda një kohe kaq të shkurtër është tregues i manipulimit të garës. Kur shohim tregjet në tërësi konkludojme se lojtarët e basteve e kanë manipuluar disa tregje njëkohësisht në faza të ndryshme të ndeshjes për të maksimizuar fitimin.



<https://www.youtube.com/watch?v=Qc5eEkt12Pg>

Për të thelluar hetimin mbi këto ndeshje, Komisioni vlerësoi si të domosdoshme thirrjen e përfaqësuesve të Skënderbeut për t`u ballafaquar me raportet. Kështu, në datën 21.04.2017 nga sekretaria teknike u njoftuar z.Illir Përmeti, shef klubi dhe portierin Orges Shehi. Në datën dhe orën e caktuar (24.04.2017 Ora 14.00), përfaqësuesit e klubit u paraqitën pranë Komisionit por u njoftuan se trupa gjyquese nuk ishte formuar për shkak të mungesës së dy anëtarëve dhe nënkryetarit. Bashkërisht u caktua një datë tjetër për zhvillimin e seancës dëgjimore ajo e 12.05.2017. Në këtë datë dhe orë përfaqësuesit e Skënderbeut njoftuan sekretariatit se ishin në pamundësi për t`u paraqitur. Duke e vlerësuar si të rëndësishme pjesëmarrjen e Klubit në proces, Komisioni caktoi datën 19.05.2017 ora 13.00 për zhvillimin e seancës, seancë në të cilën përfaqësuesit u paraqitën.

Palëve prezent u është shpjeguar se qëllim i kësaj seance është paraqitja e qëndrimit të klubit mbi hetimin e nisur nga komisioni i Etikës pranë FSHF lidhur me ndeshjet të dyshuara si të trukuara të "Skënderbeut".

Në mënyrë të përmbledhur, qëndrimi i z.Përmeti dhe z.Shehi ishte se ndeshjet e raportuara janë fituar me djersë në fushën e lojës dhe se nga momenti që ekipi hyn në fushë nuk ka dhe nuk mund të ketë asnjë dijeni për luhatjen koeficienteve të basteve. Ndeshjet e listuara nga Komisioni janë fituar nga "Skënderbeu" ndaj asnjë dyshim nuk mund të ngrihet mbi to. Ne qoftë se klubi do t`i kishte humbur ndeshjet, atëherë po që mund të ishin ngritur dyshime për tolerim. Akuzat për trukim janë krejt të pabaza. Ata po ashtu theksuan se ndaj klubit apo zyrtarëve të tij nuk ekziston asnjë vendim dënimi i formës së prerë.

Në vendimmarrjen disiplinore sportive, standardi i pranuar i provës nuk është ai i dyshimit të arsyeshëm por është ai i "dyshimit të mjaftueshëm". Ky standard prove është unifikuar nga jurisprudenca e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv për të gjitha çështjen e lidhura me integritetin. Në këtë kuadër, trupa gjyquese e Komisionit të Etikës do të vendosë në bazë të bindjes së krijuar mbi faktet e prezantuara në këtë proces.



Për evitimin e çdo paqartësie, shkeljet e kryera sipas Kodit të Etikës dhe Kodit të Disiplinës Sportive, do të analizohen me standardin që është mbi balancën e probabilitetit dhe nën "provën tej çdo dyshimi të arsyeshëm". Ky standard është pranuar botërisht edhe nga Kodi i Etikës së Komitetit Olimpik Botëror.

Mos njohja e rezultatit të ndeshjeve, pra paparashikueshmëria, përbën thelbin e futbollit të organizuar. Nëse mbështetësit, tifozët dhe të gjithë aktorët e përfshirë do të dinin rezultatit të një ndeshje, atëherë nuk do të kishte asnjë interes për të ndjekur një ndeshje futbollit. Për këtë arsye, toleranca ndaj fenomenit të trukimit duhet të jetë zero nga të gjithë palët.

Në referim të Nenit 68 të Kodit të Disiplinës Sportive, *Kushdo që komploton për influencimin e rezultatit të një ndeshje në kundërshtim me etikën sportive do të dënohet me pezullim nga ndeshjet për një periudhë prej 6 (gjashtë) muaj, si dhe me gjobë me një vlerë nga 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) Lekë deri në 3,000,000 (tre milion) Lekë. Ndërsa me verifikimin e rasteve serioze, ose rasteve të bashkëpunimit në mënyrë të organizuar, shkelësit do të dënohen edhe me përjashtim përjetë nga veprimtaritë futbollistike.*

Në rastin e verifikimit të pjesëmarrjes së një lojtari ose zyrtari në influencimin e rezultatit të ndeshjes në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, personi juridik, shoqata ose klubi ku bën pjesë lojtari ose zyrtari përkatës do të dënohet me gjobë me vlerë [prej 2.000.000 (dymilion) lekë. Në verifikimin e rasteve serioze, ose të rasteve të bashkëpunimit në mënyrë të organizuar, personi juridik, shoqata ose klubi përkatës do të dënohet edhe me zbritje të 12 (dymbëdhjetë) pikëve, përjashtim nga gara ose kampionati, ose zbritje në një kategori më të ulët.

Në analizën e të gjithë faktorëve, Komisioni nuk arriti të provojë përfshirjen direkt apo indirekte të një lojtari a zyrtari të Skënderbeut në influencimin e rezultatit të një ndeshje në kundërshtim me etikën sportive. Pavarësisht nga kjo pengesë teknike, komisioni gjykon se ka vend për krijimin e një praktike të re përputhje me Nenin 134/2 të KDS, dispozitë e cila i lejon trupës gjykues të vendosë si "legjislator", me qëllimin e vetëm respektimin e parimit gjyqësor se "Gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë



vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetim se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë.”.

Komisioni i Etikës, edhe pse nënvizon se mjetet në dispozicion për dënimin e fenomenit të trukimit të ndeshjeve, nga pikëpamja disiplinore e etike janë mjaft të kufizuara, çmon se ky fenomen nuk mund të kalojë pa u ndëshkuar.

Në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Etikës ka marrë parasysh dy aspekte themelore: se pari numrin e lartë të raporteve të gjeneruara nga klubi dhe perceptimin kombëtar dhe ndërkombëtar mbi lidhjen e klubit me trukimin e ndeshjeve. Raportet e shumta BFDS përmbajnë informacion të detajuar për tendencat e dyshimta në baste e që hartohen nga partneri kryesor i UEFA-s “Sportradar”. Kjo shoqëri zviceriane është specializuar në analizat e basteve sportive dhe ka një staf të kualifikuar certifikuar me ISO 9001 në 2014.

Lidhur me qëndrimin e klubit në gjykim, Komisioni është i qëndrimit se ai është i përgjithshëm dhe nuk reflekton detajimin që i bëhet ndeshjeve të përshkallëzuar nga raportet e BFDS. Faktin se nuk ka ndonjë vendim penal të formës së prerë Komisioni e vlerëson si aspekt dytësor. Kjo jo vetëm për mos paragjykimin e pafajësisë së “Skënderbeut” në nivel penal por për shkak se gjykimi penal me atë disiplinor janë dy aspekte të ndryshme të drejtësisë. Drejtësia penale nuk e përjashton atë sportive. Kjo do të thotë se një ngjarje e dënueshme nga pikëpamja e etikës sportive nuk është domosdoshmërisht e lidhur me një dënim penal.

Theksohet se në rastin e procedimit penal nr.6923/2016, kane qenë pikërisht raportet e UEFA BFDS që kanë shërbyer si shkas për regjistrimin e procedimit dhe jo regjistrimi penal që ka sjellë një hetimi disiplinor e etik në përputhje me Kodin e Etikës dhe Disiplinës Sportive. Gjatë hetimit Komisioni vlerësoi informacionin e ardhur nga raportet si provë të vlefshme e mjaft shteruese, fuqia provuese e të cilës është akoma më e madhe kur mbështetet nga faktorë të tjerë sportive dhe jo vetëm.

Komisioni analizoi pamje filmike nga ndeshjet, raportet e të cilave u gjykuan si të bazuara dhe konkludoi se kishte dyshime të arsyeshme se ndeshjet kishin mjaftueshëm indicje që vënë në dyshim integritetin e



tyre sipas rastit duke mos shënuar kur ishte mundësia apo duke facilituar pësimin e golave kur ekzistonin të gjitha mundësitë për ndalimin e aksioneve.

Në analizë të përmbajtjes së raporteve, komisioni gjykon se konkluzionet e tyre janë jo vetëm rezultat i analizës shteruese analitike të të dhënave por edhe i mungesës së shpjegimeve normale që do të justifikonin luhatje të tilla të basteve siç janë aksionet në fushën e lojës apo njoftime a lajme të rëndësishme mbi formacionin apo formën e një lojtari konkret. Për këtë arsye, këto sjellje mund të shpjegohen vetëm si të lidhura me paracaktimin e rezultateve sportive dhe dijeninë paraprake të bastexhinjve mbi rezultatin e garës.

Theksohet se raportet e Bet Fair Detection System përbëjnë një mjet solid në luftën kundër trukimeve dhe ndonëse mbetet hapësirë për përmirësime, ka një mundësi të lartë që një ndeshje e përshkallëzuar të jetë e trukuar. Kjo mundësi, i mjafton Komisionit për të krijuar bindjen se klubi është i përfshirë në këtë sjellje jo sportive të dënueshme.

Sakaq, aspekt shumë i rëndësishëm mbetet perceptimi i publikut në nivel kombëtar e ndërkombëtar për përfshirjen e klubit në aktivitete trukimi. Dënimi i Skënderbeut nga trupat gjykuese të Etikës e Disiplinës së UEFA, vendimi i të cilëve u konfirmua edhe nga CAS është një sinjal alarmi për futbollin vendas që vë në dyshim integritetin e garës.

Për sa më sipër, Trupa gjykuese e Komisionit të Etikës pranë Federatës Shqiptarë të Futbollit, është *mjaftueshëm e bindur* se K.F "Skënderbeu" është i përfshirë në trukimin e ndeshjeve në kundërshtim me etikën sportive. Për shkak të rëndësisë së shkeljes dhe shtrirjes së fenomenit për një pjesë të konsiderueshme të sezonit futbollistik 2015-2016, komisioni arrin në përfundimin se titulli "Kampion" i Kategorisë Superiore për këtë sezon duhet të zbrapset në përputhje me Nenin 16 të Kodit të Disiplinës Sportive pasi është fituar si pasojë e manipulimit të rezultateve.



Në përputhje me Nenin 68/2 të Kodit të Disiplinës Sportive, Klubi i Futbollit Skënderbeu duhet të dënohet me gjobë në masën 2.000.000 (dymilion) lekë. Trupa Gjyquese e klasifikon shkeljen e "Skënderbeut" si një shkelje serioze siç ajo parashikohet nga paragrafi i dytë i dispozitës ndaj e çmon të domosdoshme të aplikojë si dënim suplementar atë të zbritjes së 12 (dymbëdhjetë) pikëve nga klasifikimi. Kjo masë do të gjejë zbatim për sezonin pasardhës, pra atë 2016-2017.

KOMISIONI I ETIKES

Ne bazë të nenit 17, 18 e vijues të Kodit të Etikës dhe Neneve 16, 68/2, 134 e vijues të Kodit të Disiplinës Sportive

VENDOSI:

- Deklarimin fajtor të Klubit i Futbollit Skënderbeu për komplotim në influencimin e rezultateve të ndeshjeve në kundërshtim me etikën sportive për sezonin 2015-2016;
- Heqjen e Titullit "Kampion" i Kategorisë Superiore të KF Skënderbeut për sezonin 2015-2016;
- Dënimin e KF Skënderbeu me gjobë në masën 2.000.000 (dy milion) lekë;
- Dënimin e KF Skënderbeu me zbritjen e 12 (dymbëdhjetë) pikëve nga klasifikimi për sezonin 2016-2017;
- Kundër këtij vendimi, lejohet ankim sipas nenit 18 të Kodit të Etikës.

U shpall në Tiranë më 23.06.2017

KOMISIONI I ETIKES

Fatmir Braka (Kryetar)

Bejkush Birçe (Zv/Kryetar)

Bashkim Koka (Anëtar)

Agron Kuliçaj (Anëtar)

Ardian Leka (Anëtar)